



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 18 datë 20.2.2023

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË PËRFITUESVE PRANË BANESAVE SOCIALE ME QIRA TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA SHKODËR”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; pikës 5, të nenit 15 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pikës 18 të VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM-së nr. 301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”; VKB-së nr. 23, datë 10.05.2022 “Për miratimin e masës së qirasë për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare”; VKB-së nr. 24, datë 10.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare dhe të “Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër”; VKB-së nr. 25, datë 10.05.2022 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6 dhe banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2022”; VKB-së nr. 32, datë 13.06.2022 “Për miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë dhe përjashtimin nga pagesa e qirasë të përfituesve të subvencionimit në raport me nivelin e të ardhurave për përfituesit e banesave sociale me qira të administruara nga bashkia Shkodër”; VKB-së nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër”; Marrëveshjes së bashkëpunimit “Për strehimin e jetimëve në qytetin e Shkodrës”, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Bashkisë së Shkodrës, me nr. 2691 prot, datë

07.03.2016; "Procesverbalit përfundimtar të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër, me nr. 18336/1 prot, datë 20.12.2022", si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën shtesë të përfituesve pranë Banesave Sociale me Qira të administruara nga Bashkia Shkodër, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak



Denis Lesha

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 24.2.2023

Programi: Banesa Sociale me Qira (QKF nr. 6 - Pjajore, Veterinare dhe Rome)

Lënda: Lista e përfituesve

Nr. Rendor	Emri / Atësia / Mbiemri	Përbëja familjare	Struktura e apartamentit që përfillon	Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	BSQ
1	Klodiana Qamil Gjana	3	1+1	Nuk ka banesë në Pronësi	Fam. njëprindërore	Viktimë dhune	Pa të ardhura	QKF nr. 6-Pjajore
2	Marjeta Tomë Simoni	1	Garsonier	Nuk ka banesë në Pronësi		Viktimë trafikimi	Pa të ardhura	QKF nr. 6-Pjajore
3	Fahri Faik Kadija	2	1+1	Nuk ka banesë në Pronësi	I moshuar		28.500 lekë	Veterinare
4	Lulash Fran Bregu	3	1+1	Nuk ka banesë në Pronësi			Pa të ardhura	Veterinare
5	Bardhyl Binak Mekriznani	5	2+1	Nuk ka banesë në Pronësi		PAK, minoriteti Egjiptian	Pa të ardhura	Rome
6	Vera Ibrahim Hoti	3	1+1	Nuk ka banesë në Pronësi	Fam. njëprindërore		Pa të ardhura	Rome
7	Zamir Mynyr Gatali	6	2+1	Nuk ka banesë në Pronësi		Minoriteti Rom, azilkërkues	Pa të ardhura	Rome

OK

